



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 2

Tiranë – E hënë, 17 janar 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Njoftim i Institucionit të Presidentit të Republikës nr. 190, datë 13.1.2022	Për hapjen e procedurave të aplikimit për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë me mandat 9-vjeçar)	3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 356, datë 11.1.2022	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.....	5
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 359, datë 11.1.2022	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të shoqërisë “Kamberi” sh.p.k., si dhe të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë.....	6
Kërkesë e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nr. 61, datë 12.1.2022	Për botimin e vendimit për dënim administrativ ndaj subjektit “Altin Sadiku”.....	9



DEKRET

Nr. 13413, datë 13.1.2022

**PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË
APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E
VENDIT VAKANT GJYQITAR NË
GJYKATËN KUSHTETUESE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pika 1/b, 3, 179, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, 7/a, 7/b, 86, pika 4, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pas administrimit të shkresës nr. 11 prot., datë 7.1.2022, të krytares së Gjykatës Kushtetuese, me të cilën njoftohet se Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 42, datë 22.12.2021, ka vendosur: “Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo, në datën 8.4.2022”, për shkak të përfundimit të mandatit 9-vjeçar të plotësuar prej tij, me cilësinë e organit të emërtesës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e “Vakancës së plotë”, me mandat 9-vjeçar, që krijohet më datë 8.4.2022.

Neni 2

Shpallja e kësaj procedure dhe publikimi i saj, sipas tekstit bashkëlidhur, të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta**

NJOFTIM

Nr. 190, datë 13.1.2022

**PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË
APLIKIMIT PËR VENDIN VAKANT
GJYQITAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE (VAKANCË E PLOTË
ME MANDAT 9-VJEÇAR)**

Presidenti i Republikës, pasi u njoh me njoftimin e krytares së Gjykatës Kushtetuese nr. 11 prot., datë 7.1.2022, përmes të cilit bëhet me dije, se Gjykata Kushtetuese, me vendim nr. 42, datë 22.12.2021¹, ka vendosur: “Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo, në datën 8.4.2022”, duke u konstatuar kështu ligjërisht fakti, se në datën 8.4.2022, në Gjykatën Kushtetuese krijohet një vakancë me mandat të plotë, për shkak se kjo datë konsiderohet përfundimi i mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo (*i cili u emërua në këtë gjykatë, në plotësim të vakancës së parakohshme të shkaktuar nga largimi i parakohshëm nga detyra të ish-gjyqarit z. Besnik Imeraj, dhe sipas nenit 127, pika 3, të Kushtetutës, qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar*), në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pika 1/b, 3, 179, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, 7/a, 7/b, 86, pika 4, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, **Presidenti i Republikës, me cilësinë e organit të emërtesës dhe me qëllim plotësimin e “Vakancës së plotë”, me mandat 9-vjeçar, që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, në datën 8.4.2022, me [dekretin nr. 13 413, datë 13.1.2022](#), ka miratuar:**

- Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e “**Vakancës së plotë**”, me mandat 9-vjeçar, që krijohet më datë 8.4.2022.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit, nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000,

¹ Njihu me vendimin nr. 42, datë 22.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese:
https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php



“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës:

- kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;

- jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (adresë, numër telefoni/e-mail);

- fotokopje të kartës së identitetit;

- dokumentacionin shoqërues, nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

- formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe të nënshkruar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Formulari i vetëdeklarimit është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës;

- formularin e aplikimit të plotësuar “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës.

- listën e dokumentacionit, që dorëzohet bashkëlidhur kërkesës së nënshkruar nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë, gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pikat 4 e 5, të Kushtetutës dhe të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 125

[...] 4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si

gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë e nivelit të dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit nga data e kandidimit;

d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

e) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe të verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, juristi nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësi të profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

a) vjetërsisë në profesion;



b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a i Gjykatës së Lartë;

c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;

e) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm është brenda datës 4 shkurt 2022.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, si dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim, sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës do të bëjë transparent çdo rezultat të këtij procesi, në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti: Numrat e telefonit: 04238956/042389825

NJOFTIM
Nr. 356, datë 11.1.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, kreu V, pika 1; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, kapitulli III, pika 16, shpallen për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi	Viti prodhimit	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Mitsubishi Pajero	1996	170 000	28.1.2022	09:30	DDPP DDPP
2	Mercedes Benz 200D	1989	30 000	28.1.2022	10:00	DDPP
3	Mercedes Benz E 220 CDI	2000	200 000	28.1.2022	10:30	DDPP
4	Mercedes Benz S350D	1993	120 000	28.1.2022	11:00	DDPP
5	Mercedes Benz 190 D	1989	30 000	28.1.2022	11:30	DDPP
6	Kamion Volvo HYF 1018+ Rimorkio Crone SDP-24	1985	600 000	28.1.2022	12:00	DDPP
		1995				



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në original, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhet pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM
Nr. 359, datë 11.1.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, TË SHOQËRISË “KAMBERI” SHPK, SI DHE TË INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, shpallen për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Arë			Data	Ora	Vendi
1	Tokë arë	Yzberisht, Tiranë	965 250	0	965 250	1 485	0	9.2.2022	10:00	DDPP

2. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Bodrum me nr. 5/56-B2	Shëngjin, Lezhë	643 312	0	643 312	11.6		9.2.2022	10:30	DDPP



3. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Bodrum me nr. 5/56-B3	Shëngjin, Lezhë	643 312	0	643 312	11.6		9.2.2022	11:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimi të

1. Në pronësi të shoqërisë “Kamberi” administrim sh.p.k.

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Moto Gjenerator, marka TROGENO-TORINO, e tipit MV nr. 118	Rruga “Pirro Godo”, Tiranë	110 000	9.2.2022	09:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhet pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM Nr. 359, datë 11.1.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË SHOQËRISË “KAMBERI” SHPK

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin



e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhet pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM
Nr. 359, datë 11.1.2022

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE NË
ADMINISTRIM TË INSTITUTIT TË
PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË,
TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Lisa	5.3.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	11:15	DDPP
2	Qeni Laza	5.3.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	11:30	DDPP
3	Qeni Deja	5.3.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	11:45	DDPP
4	Qeni Deni	8.4.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	12:00	DDPP
5	Qeni Maxhi	8.4.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	12:15	DDPP
6	Qeni Jul	18.7.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	12:30	DDPP
7	Qeni Xhena	18.7.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	12:45	DDPP
8	Qeni Zita	25.7.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	13:00	DDPP
9	Qeni Jona	19.1.2013	Tiranë	8 000	9.2.2022	13:15	DDPP
10	Qeni Orsa	19.1.2013	Tiranë	8 000	9.2.2022	13:30	DDPP
11	Qeni Dea	03.9.2013	Tiranë	8 000	9.2.2022	13:45	DDPP
12	Qeni Lukas	03.9.2013	Tiranë	8 000	9.2.2022	14:00	DDPP
13	Qeni Diksi	11.5.2011	Tiranë	8 000	9.2.2022	14:15	DDPP
14	Qeni Dei	3.10.2013	Tiranë	8 000	9.2.2022	14:30	DDPP
15	Qeni Riku	3.10.2013	Tiranë	8 000	9.2.2022	14:45	DDPP
16	Qeni Konti	15.9.2012	Tiranë	8 000	9.2.2022	15:00	DDPP
17	Qeni Fels	14.10.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	15:15	DDPP
18	Qeni Grei	14.10.2020	Tiranë	20 000	9.2.2022	15:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.



Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.

KËRKESË

Nr. 61, datë 12.1.2022 PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “ALTIN SADIKU”

Agjencitë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, megjithëse kanë realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit

postar, është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar: Largim i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, institucioni ynë bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të Agjencive Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. “Altin Sadiku” (NIPT: L32304060U)

DREJTOR
Oltian Gjyzeli

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. AKM-TR-2021-000241-5

Datë 6.12.2021

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. AKM-TR-2021-000241-2, datë 18.11.2021, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Altin Sadiku”, me NIPT: L32304060U, përfaqësues i autorizuar i subjektit z. Altin Sadiku, administrator, prej datës 17.11.2021, ora 08:00 deri më datë 17.11.2021, ora 14:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 18.11.2021 dhe e njoftoi më datë 18.11.2021.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 21, pika 10.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit:

- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 62, pika 10, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 300 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

- 30.11.2021 – Paraqitja e fakteve apo e dokumentacioneve për shkeljet e konstatuara.

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Fatime Meta ID:

Bruno Sadiku ID:

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “Altin Sadiku” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “organit epror” të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022